

KOSOVO ECONOMIC INTEGRATION IN THE EUROPEAN UNION

Ruzhdi Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, clirimi@hotmail.com

Abstract: The European Union today differs significantly from the integration project launched in the 1950s, originally conceived as a way to maintain peace and enable economic recovery among the six Western European countries, the EU has developed one of the strongest trading blocs in the world spanning most of the European continent.

Disputes over the ratification of the Lisbon Treaty and disagreements over policy reforms and the way in which funding has caused fundamental disagreements over the future direction of the EU. The sovereign debt crisis in the eurozone brought economic difficulties in many countries, prompting some analysts to conclude that the Monetary Union had indeed been a step too far from European integration.

Regardless of the outcome of this debate, the European Union represents an extremely influential tool for European organization and constitutes a unique experiment of "deep" international cooperation. Economically, at least until the eurozone crisis, it has raised levels of prosperity. Politically it has fostered the democratic transition of the former fascist and communist dictatorships. Others accuse the EU of lacking transparency and accountability in its institutional processes, and some say European integration has led to the gradual erosion of national and cultural differences and traditions, while many citizens in countries affected by the difficult situation The financial crisis caused by the sovereign debt crisis began to call into question the legitimacy and sustainability of the European project.

Kosovo is facing a unique challenge and opportunity - internal reforms in the process of state building can simultaneously make the transformation needed to become an EU member state.

Keywords: Integration, European Union, SAA, Stabilization and Association, Economy, Market.

INTEGRIMI EKONOMIK I KOSOVËS NË BASHKIMIN EUROPIAN

Ruzhdi Kabashi

Kolegji "BIZNESI" Prishtinë, Kosovë, clirimi@hotmail.com

Abstrakt: Bashkimi European sot ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga projekti i integritimit që filloi në vitet 50-ta, konceptuar fillimisht si një mënyrë për të ruajtur paqen dhe për të mundësuar rimëkëmbjen ekonomike në mesin e gjashtë vendeve të Europës Perëndimore, BE-ja ka zhvilluar një nga blloqet më të forta tregtare në botë që përfshin pjesën më të madhe të kontinentit evropian.

Polemikat mbi ratifikimin e Traktatit të Lisbonës dhe mosmarrëveshjet lidhur me reformat e politikave dhe mënyra e financimit shkaktuan mosmarrëveshje themelore mbi drejtimin e ardhshëm të BE-së. Kriza e borxhit sovran në eurozonë solli vështirësi ekonomike në shumë vende që nxitën disa analistë të konkludojnë se dhe Bashkimi Ekonomik Monetar kishte qenë me të vërtetë një hap shumë larg integritimit evropian.

Pavarësisht nga rezultati i këtij debati, Bashkimi European përfaqëson një mjet jashtëzakonisht me ndikim për organizimin European dhe përbën një eksperiment unik të bashkëpunimit "të thellë" ndërkombëtar. Ekonomikisht, të paktën deri në krizën e eurozonës, ajo ka rritur nivelet e prosperitetit. Politikisht ajo ka nxitur tranzicionin demokratik të ish diktaturave fashiste dhe komuniste. Të tjerët e akuzojnë BE-në për mungesë të transparencës dhe llogaridhënies në proceset e saj institucionale, dhe disa thonë se integrimi evropian ka çuar në erozion gradual të dallimeve dhe traditave kombëtare dhe kulturore, ndërkohë që shumë qytetarë në vendet e prekura nga situata e vështirë financiare që u shkaktua nga kriza e borxhit sovran filluan të vënë në dyshim legjitimitetin dhe qëndrueshmërinë e projektit evropian.⁵⁹

*''Kosova është para një sfide dhe mundësie unike – reformat e brendshme në procesin e ndërtimit të shtetit njëkohësisht mund të bëjnë transformimin e nevojshëm për tu bërë shtet anëtarë i BE-së.''*⁶⁰

Fjalet kyqe: Integrim, Bashkim European, MSA, Satabilizim Asociim, Ekonomi, Treg.

⁵⁹ Andreas Staab, "The European Union Expland", London 2012, fq. 9-11.

⁶⁰ Venera Hajrullahu Fatmir Curri, "Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore të Kosovës në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin European", Prishtine 2007, fq.3

1. MSA, MUNDËSI DHE SFIDË PËR KOSOVËN

Vendet që shprehin dëshirën e tyre që të bëhen pjesë e BE-së, duhet më parë të jenë pjesë e shumë negociatave, siqë është të nënshkruajnë MSA-në, e cila është një kuadër ligjor dhe një përkushtim për reforma politike, ekonomike, tregtare ose reforma për të drejtat e njeriut. Në këmbim të këtyre reformave, BE-ja u ofron vendeve me të cilat nënshkruan këtë marrëveshje heqjen e taksave nëpër tregjet europiane për disa produkte si dhe u ofron ndihmë financiare dhe teknike. MSA është pjesë e Procesit të Stabilizim Asociimit të BE-së si dhe Politikës për Fqinjësi të Mirë. Përfitimet më të mëdha dhe më të drejtpërdrejta për vendet nënshkruese të MSA-së janë në fushën e tregtisë, pasi që lejohet hyrja më e lirë e produkteve vendëse në tregun e përbashkët europian.⁶¹

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) përfaqëson marrëdhënien e parë kontraktuale midis Kosovës dhe BE-së dhe kjo konsiderohet si pikë kthesë e rëndësishme në procesin e integritimit europian të Kosovës.

MSA-ja nuk është vetëm një marrëveshje e tregtisë, por shkon përtej saj për nga natyra dhe përmbajtja. Marrëveshja është një dokument voluminoz, i ndarë në dhjetë kapituj që mbulojnë çështjet që shtrihen nga ajo se si do të ndërveprojmë politikisht (dialogu politik); bashkëpunimi rajonal, lëvizja e lirë e mallrave, furnizimi i shërbimeve dhe kapitalit, përafrimi i ligjeve të Kosovës me ato të BE-së, bashkëpunimi për lirinë, sigurinë dhe drejtësinë, si dhe në sektorët e tjerë, ndihma financiare e BE-së për reformat në Kosovë, dhe në cilat organe do të punojnë bashkërisht. Disa nga dispozitat e marrëveshjes janë të përbashkëta me vendet e tjera, teksa dispozitat e tjera janë unike për Kosovën. Në përgjithësi, marrëveshja përcakton objektiva të qarta politike dhe ekonomike në arritjen e të cilave Kosova është zotuar të punojë gjatë viteve të ardhshme. MSA-ja, mbulon të gjitha fushat, të cilat BE-ja dhe Kosova i konsiderojnë thelbësore: demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, ekonominë e tregut dhe tregtinë, si dhe bashkëpunimin rajonal e marrëdhëniet e mira fqinjësore. Sikurse edhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, MSA-ja përmban detyrime për të dy palët. Për të përcjellë dhe inkurajuar zbatimin e këtyre detyrimeve dhe reformave në përgjithësi, ajo gjithashtu krijon disa organe mbikëqyrëse për zbatimin e saj.⁶²

2. MSA-JA DHE EKONOMIA

Kosova me shkallën më të lartë të papunësisë në Europë dhe zhvillimin ekonomik që po lëvizë shumë ngadalë, është e nevojshme një përpjekje e madhe, duke përfshirë reformat dhe investimet, për të përmirësuar kushtet ekonomike. Përdërisa nënshkrimi i MSA-së me BE-në është një hap pozitiv në vetvete, zbatimi i saj do të hapë rrugën për qasje në tregje të reja, përmirësime në standardet e prodhimit dhe standardizim, gjë që nga ana tjetër do ta rrisë eksportin potencial dhe do të ndihmojë zhvillimin e biznesit vendor, rritjen e sigurisë si dhe besimit për investitorët e huaj. Të gjitha këto duhet të kontribuojnë në prosperitet më të madh dhe mundësi punësimi në tërë Kosovën. MSA-ja do të vë në dispozicion për qytetarët produkte më të shumta e më të mira. Gjatë zbatimit të MSA-së, Kosova pritet që gradualisht të përqafojë dhe zbatojë standardet europiane për produktet, sidomos për sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve dhe cilësisë së produkteve. Avancimi i pozitës së Kosovës në tregtinë ndërkombëtare është një tjetër objektivi i MSA-së, duke ndihmuar rregullimin e mosbalancimit tregtar aktual, nëpërmjet ofrimit të mundësive të reja për eksportet nga Kosova.

MSA-ja ka për qëllim të vendos produktet e BE-së dhe Kosovës (të cilat përmbushin standardet e cilësisë të BE-së) në një fushë loje të niveluar, duke i dhënë shumicës së produkteve të Kosovës qasje të pakufizuar në tregun e BE-së. Për shembull, një prodhues i verës në Rahovec nuk e ka të garantuar vetëm tregun në Kosovë, por tani mund të përfitojë nga kuota e Kosovës për eksport të verës, që është rritur dhe tanimë është e garantuar nga MSA-ja, duke i dhënë qasje në mbi 500 milionë konsumatorë potencial. Shumica e produkteve industriale dhe bujqësore të Kosovës tani do të kenë qasje të garantuar në tregun e BE-së. Në disa raste, Kosova do të jetë në gjendje të mbrojë tregun e saj për produkte të caktuara (p.sh. produktet e qumështit, mollët dhe patatet), ashtu që produktet e BE-së, vetëm gradualisht të arrijnë trajtim të barabartë, duke u dhënë kohë prodhuesve të Kosovës për të përmirësuar cilësinë dhe standardet e tyre për të qenë konkurrues në këta sektorë. MSA-ja, megjithatë, nuk është preventivë ekonomike për të gjitha. Kosova do të vazhdojë të përballet me sfida serioze ekonomike. Qasja e garantuar në tregjet e BE-së, do të sjellë përfitime të plota vetëm nëse gama dhe cilësia e produkteve të Kosovës përmirësohet për të qenë sa më konkurruese që është e mundur. MSA-ja do ta japë potencialin e saj të plotë nëse Kosova fokusohet në forcimin e sektorëve të orientuar në tregjet e eksportit, zhvillon infrastrukturën e cilësisë për të sjellë produktet në ato tregje, siguron se produktet dhe eksportet përmbushin standardin shëndetësor, sigurinë dhe cilësinë e BE-së. Gjithashtu vazhdon të forcojë dhe të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, në mënyrë që ato të mund të veprojnë në tregun e përbashkët konkurrues të BE-së.

⁶¹ Në dispozicion tek: <http://telegrafi.com/cka-eshte-msa-ja-dhe-cka-perfiton-kosova-nga-kjo/>

⁶² Nasir Selimi, "Globalizimi ekonomik", Tetovë 2008, fq. 125.

Pasi që asgjë nuk ndodhë në izolim çdo gjë është e lidhur, këto reforma thelbësore ekonomike shkojnë krahas me përmirësimin e nivelit të demokracisë, sundimit të ligjit e të drejtave të njeriut, për të përfituar plotësisht nga MSA-ja. BE-ja do të sigurojë mbështetje teknike dhe këshilla, nga përvoja e vet, nëpërmjet strukturave të përcaktuara sipas Marrëveshjes. Do të vazhdojë të ofrojë mbështetje financiare për përpjekjet e Kosovës për të arritur prioritetet dhe synimet e ndërsjella të reformave. Por vullneti politik është kyç - implementimi i reformave dhe zotimeve të parapara në MSA.⁶³

Vëmendje e veçantë i është kushtuar ristrukturimit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (në mënyrë që të jetë në gjendje për të negociuar komponentat lidhur me MSA-në) kapacitetet e hartimit të ligjeve sa i përket Ministrisë së Drejtësisë.⁶⁴

“Sa do të jetë Kosova në gjendje të përfitojë nga MSA-ja do të varet nga aftësitë e Kosovës për të rritur prodhimin dhe me këtë edhe eksportin në BE, për të përfituar nga kjo marrëveshje edhe në profesionalizmin e administratës dhe përafritimit të standardeve me ato të BE-së në të gjitha fushat të cilët i përfshin MSA-ja.”⁶⁵

3. INTEGRIMI I KOSOVËS NË BE

Aktualisht, shtetet anëtare të BE-së si dhe BE-ja po japin sinjale të qarta se ata synojnë që të forcojnë marrëdhënien me Kosovën dhe se Kosova është në rrugë të mbarë drejt BE-së. Në të vërtetë, Kosova është duke u përgatitur për të hyrë në një fazë të re të marrëdhënieve të veta me Bashkimin Europian. Republika e Kosovës, përkatësisht institucionet dhe populli i saj, janë plotësisht të përkushtuar ndaj procesit të integritit evropian me synimin e qartë për t'u anëtarësuar në BE. Në mënyrë që të përmbushet kjo pritje, është thelbësore që të zhvillojmë më tutje dhe të ruajmë një konsensus mbarëkombëtar dhe vizion për integritin evropian.

Përvoja nga rajoni dhe nga shtetet anëtare të reja të BE-së tregon se ruajtja e vizionit dhe konsensusit, ndonëse i vështirë, ka dëshmuar se është thelbësor për procesin e integritit evropian.

Në mënyrë që të shfrytëzohet ky momentum, u konsiderua si e nevojshme hartimi i një Strategjie Kombëtare për Integritin Evropian. Strategjia pasqyron vizionin dhe qëllimin e Kosovës për të përshpejtuar procesin e integritit evropian dhe trajton mangësitë serioze me të cilat Kosova ende po ballafaqohet, si dhe shtjellon synimet që ne synojmë t'i arrijmë për ta afruar Kosovën me BE-në.

Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është që deri në vitin 2020 Kosova të jetë më mirë e përgatitur për integritin në BE. Me qëllim të arritjes së këtij qëllimi, strategjia identifikon pesë objektiva me prioritetet që duhet të arrihen:

1. Efektshmëria e qeverisjes;
2. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
3. Zhvillimi ekonomik;
4. Përfshijra e palëve me interes;
5. Marrëdhëniet e avancuara (kontraktuale) me Bashkimin Europian.

Arritja e objektivit të efektshmërisë së qeverisjes, do ta shpie Kosovën drejt realizimit të qëllimit kryesor të kësaj strategjie. Në këtë mënyrë, ky objektivë thekson nevojën për të pasur një sistem koherent dhe të qëndrueshëm të hartimit të politikave dhe legjislacionit. E trajton çështjen e investimit në cilësi dhe zbatim më të mirë të politikave tona përmes planifikimit strategjik dhe mekanizmave mbikëqyrës. Gjithashtu, nënvizon rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve të shërbimit civil për performancë më të mirë të institucioneve. Prandaj kjo objektivë trajton të gjithë sektorët ku duhet të ndërmerren reformat në rrugën drejt integritit evropian. Strategjia përqendrohet veçanërisht në luftimin efektiv të korrupsionit dhe krimit të organizuar si synim të dytë kryesor. Ajo përqendrohet në përmirësimin e efektivitetit të strukturës institucionale dhe mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Zhvillimi ekonomik, është objektiv i tretë që ne duhet ta arrijmë në procesin e integritit evropian. Qeverisja e mirë ekonomike, një ekonomi konkurruese e tregut, një mjedis i favorshëm për investime dhe lëvizja e lirë e qytetarëve do të ndihmojnë në arritjen e këtij synimi.

“Funksionimi i sistemit të sundimit të ligjit është më se i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe integritin e saj në Bashkimin Europian. Ndonëse ekziston një përkushtim verbal nga autoritetet e Kosovës për

⁶³ Qendra Informativë dhe Kulturore e BE-së, “MSA-ja për të gjithë: Çfarë duhet të dini për marrëveshjen për stabilizim dhe asociim ndërmjet BE-së dhe Kosovës?”, Autor: Krenar Gashi, shih më shumë tek: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/161013_saa_sq_0.pdf.

⁶⁴ M.Smith - S.Keukeleire - S.Vanhoonaeker, “The Diplomatic System of the European Union”, New York 2016, fq.28.

⁶⁵ “Çka pas MSA-së mes BE-së dhe Kosovës”, Ne dispozicion tek: <http://koha.net/?id=31&o=647>.

forcimin e sundimit të ligjit, problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova në këtë fushë janë komplekse dhe të shumta, ndërsa duhet të investohet në shumë burime për të arritur deri te përmirësimet e nevojshme’’.⁶⁶

Objektivi i katërt është përfshirja e palëve me interes në procese të ndryshme. Ai shpjegon rëndësinë e përfshirjes së palëve të ndryshme me interes, akterëve shtetërorë dhe jo-institucional, në avancimin e jetës tonë institucionale si dhe rëndësinë e tyre për përmirësimin e hartimit dhe monitorimit të politikave.

Përfundimisht, me qëllim të arritjes së qëllimit kryesor për ta përgatitur vendin tonë më mirë për integrim evropian, është thelbësor investimi në marrëdhënie të avancuara (kontraktuale) me BE-në. *"Ky dimension i përket kritereve të brendshme edhe të jashtme. Për këtë qëllim, kjo objektivë ofron udhëzime për atë se ku duhet të përqendrohet Kosova në të ardhmen e afërt*’’.⁶⁷

Proceset për krijimin e legjislacionit parësor dhe dytësor kërkojnë më shumë përqendrim në qasjen "politikat-paraligjit" dhe duhet të jenë më të hapura edhe më shumë drejt transparencës dhe pjesëmarrjes demokratike para miratimit të legjislacionit. Kosova ka nevojë për siguri dhe qartësi juridike, veçanërisht në fusha të ndieshme si, të drejtat pronësore, meqë vetëm një siguri, qartësi dhe stabilitet i tillë juridik do të krijonte kornizën e domosdoshme për investime dhe ndërmarrësi, e cila Kosovës do t'i sillte zhvillimin më se të nevojshëm ekonomik dhe stabilitetin social.⁶⁸

4. MEKANIZMAT PËRGJEGJËS NË PROCESIN E INTEGRIMIT

Procesi i integrimit evropian nuk duhet të konsiderohet si një proces burokratik i menaxhuar vetëm nga institucionet shtetërore. Angazhimi i të gjitha palëve të interesuara në planifikimin dhe zbatimin e politikave është vendimtarë, kjo sepse agjenda e integrimit shkakton reforma të thella në të gjitha sferat e shoqërisë. Si element thelbësor i qeverisjes së mirë në përgjithësi, si dhe për procesin e Integrimit Evropian në veçanti, kjo strategji thekson rëndësinë e përfshirjes së palëve me interes në planifikimin e politikave në Kosovë. *"Shprehja "palët me interes" i referohet këtu një përkufizimi më të gjerë që përfshinë të gjithë akterët që marrin pjesë në procesin e hartimit të politikave, duke përfshirë institucionet shtetërore dhe akterët jo-institucional sikurse organizatat e shoqërisë civile (OSHC), përfaqësuesit e sektorit privat dhe sindikatat por edhe botën akademike dhe masmedian*’’. Përfshirja e një game të gjerë të palëve me interes në procesin e hartimit të politikave është një ndër gurëthemelet e hartimit të politikave në BE. BE-ja promovon përfshirjen e palëve me interes në shumë mënyra dhe në shumë nivele, në mënyrë zyrtare, si dhe jo-formale.

5. KËSHILLI MINISTROR PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN

Këshilli Ministror zbaton politikat uniforme të Republikës së Kosovës për integrimin evropian duke lehtësuar, brenda spektrit të funksioneve dhe të drejtave të tij, koordinimin e aktiviteteve të ministrive dhe organeve të tjera për integrim

Disa nga funksionet e Këshillit Ministror:

Të koordinojë politikat uniforme shtetërore, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së Republikës së Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, dhe të përcaktojë fushat kryesore prioritare, aktivitetet për zbatimin e prioriteteve dhe afatet për zbatimin e tyre;

Të diskutojë pozitat negociuese dhe çfarëdo çështjesh të tjera të lidhura me negociatat me Komisionin Evropian dhe Shtetet Anëtare para dorëzimit të këtyre pozitave dhe çështjeve nën negociim për vendim në mbledhjet e rregullta të Qeverisë së Republikës së Kosovës;

⁶⁶Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK), Robert Muharremi, "KOSOVA DHE INTEGRIMI I SAJ NË BASHKIMIN EVROPIAN: Sfidat e themelimit të shtetit funksional të bazuar në sundimin e ligjit", Prishtine 13 April 2008, fq.1

Në dispozicion tek:

[http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-\[shqip\].pdf](http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-[shqip].pdf),

⁶⁷Republika e Kosovës-Presidenti, Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian, "STRATEGJIA KOMBËTARE INTEGRIMIN EVROPIAN KOSOVA 2020", fq.4-11, shih më shumë tek: http://www.kryeministri.ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Integrimin_Evropian_Kosovo_2020_SHQ.PDF,

⁶⁸KOSOVA DHE INTEGRIMI I SAJ NË BASHKIMIN EVROPIAN: Sfidat e themelimit të shtetit funksional të bazuar në sundimin e ligjit", Kosovë 13 Prill 2008, fq.22.

Në dispozicion tek:

[http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-\[shqip\].pdf](http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-[shqip].pdf)

Të sigurojë një proces të planifikuar mirë dhe gjithëpërfshirës të përafrimit të akteve ligjore të Republikës së Kosovës me kërkesat e së drejtës së Komunitetit Europian;

Të koordinojë zhvillimin dhe administrimin e programeve dhe aktiviteteve që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të ministrive dhe organeve të tjera shtetërore me qëllim të adresimit në mënyrë adekuate të kërkesave të procesit të Integritimit Europian;

Të vendosë mbi çështjet që lidhen me koordinimin e shfrytëzimit të asistencës së BE-së dhe asistencës bilaterale të donatorëve nëse kjo e fundit u destinohet çështjeve të Integritimit Europian, para dorëzimit të këtyre çështjeve për vendim në sesionet e rregullta të Qeverisë së Republikës së Kosovës.⁶⁹

6. KOMITETI PUNUES PËR INTEGRIM EUROPIAN

Komiteti Punues është organi koordinues shtetëror në nivelin e Sekretarëve të Përgjithshëm të ministrive dhe kryesuesëve të organeve shtetërore, të cilët, brenda spektrit të funksioneve dhe të drejtave të veta, sigurojnë bashkëpunimin e ministrive dhe organeve tjera shtetërore në çështjet që lidhen me integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Europian.

Funksionet e Komitetit:

- ✓ Të konsiderojë propozimet e ministrive dhe organeve tjera shtetërore për prioritetet e Qeverisë së Kosovës lidhur me integrimin në Bashkimin Europian;
- ✓ Të përpunojë propozimet lidhur me politikat uniforme të Qeverisë së Kosovës në fushat që lidhen me integrimin në Bashkimin Europian;
- ✓ Të pajtohet në ndarjen e përgjegjësisë në mes të ministrive dhe organeve tjera shtetërore lidhur me përmbushjen e prioriteteve të Qeverisë së Kosovës në fushat e Integritimit Europian;
- ✓ Të diskutojë të gjitha çështjet që lidhen me negociatat me Komisionin Europian për Marrëveshjen e Përkohshme dhe Shtetet Anëtare të BE-së;
- ✓ Të konsiderojë dhe të pajtohet me propozimet e ministrive përgjegjëse për përpunimin e akteve ligjore të Republikës së Kosovës.

Kjo task forcë përbën në vetvete një metodë praktike, e cila do të ndihmojë në arritjen e konsensusit mes akterëve më të rëndësishëm lidhur me integrimin evropian të Kosovës dhe të mbështetjes së MIE-së për zbatimin e mandatit në përpjekjet e saj për bashkërendim të punëve. Objektivi i përgjithshëm i Task Forcës për Integrim Europian është hartimi i një strategjie për integrim evropian, duke arritur konsensus në mes të palëve kryesore si dhe dhënien e rekomandimeve për Qeverinë e Kosovës në këtë drejtim. Zbatim i kësaj strategjie, duke i shfrytëzuar përvojat e shteteve anëtare të BE-së dhe të vendeve të tjera, të Komisionit Europian, dhe të organeve të tjera, do të shpie në përsheptimin e mëtejshëm të procesit të integritimit evropian, duke e sjellë Kosovën më afër anëtarësimit në Bashkimin Europian.⁷⁰

7. GRUPET PUNUESE PËR INTEGRIM EUROPIAN

Spektri i detyrave për secilin Grup Punues përfshinë:

- ✓ Strategjinë dhe planin e aktiviteteve në procesin e Integritimit Europian në fushën e mandatit të vet. Aktivitetet duhet të përfshijnë zhvillimin e politikave që ndërlihen, si dhe aktivitetet e përafrimit të ligjit, aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitetet teknike që lidhen me këto politika.
- ✓ Brenda kompetencave të veta – monitorimin e progresit në fushën e përafërimit të ligjit, përkthimit të *Acquis communautaire* në gjuhët kombëtare, dhe ndihmën e donatorëve, sidomos ato aktivitete që formojnë pjesën e Planit të Veprimit për Partneritetin Europian;
- ✓ Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të ministrive apo organeve tjera për zbatimin e aktiviteteve të përmendura.
- ✓ Me propozimin e kryesuesit, zëvendës kryesuesit apo shumicës së anëtarëve të Grupit Punues të diskutohen çështjet tjera të ndërlidhura brenda spektrit të mandatit.

8. KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIM EUROPIAN

1. Bashkëpunon dhe shkëmben praktikat-Monitoron procesin e harmonizimit të sistemit ligjor të Kosovës me një sistem ligjor të Bashkimit Europian

⁶⁹Republika e Kosovës, Ministria e Integritimit Europian, Në dispozicion tek: <http://www.mei-ks.net/sq/strukturat-per-integrimbr-evropian>.

⁷⁰Raporti i Ministrisë për Integritime Evropiane dhe GIZ, "Task Forca për Integrim në Bashkimin Evropian", Prishtinë, Maj 2012, fq.11, Shih më shumë tek:

http://www.mei-ks.net/repository/docs/Terms_of_Reference_SQ.pdf

2. Rishikon projekt-ligjet dhe amendamentet e propozuara të projekt-ligjeve nga një Komision tjetër i Kuvendit nga aspekti i përafrimit dhe përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.
3. Bashkëpunon dhe siguron koordinimin me parlamentet e shteteve anëtare të BE-së.

9. REKOMANDIME

- Përafrimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Europian duhet të jetë prioriteti kryesor i insitucioneve dhe akterëve tjerë relevant të inkuadruar në procesin e integritimit në BE, e dimë që Kosova që nga pas lufta ka filluar harmonizimin e legjislacionit dhe përmbushjen e kriterëve të ndryshme, me qëllim të përafrimit me BE-në;
- Harmonizimi i legjislacionit në të njëjtën kohë apelim institucional e qytetar të përcillet me zbatimin e tij, anadaj në këtë drejtim duke parë sfidat e shumëta, duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme në mënyrë që legjislacioni mos të mbetet vetëm në letër por, të zbatohet në praktikë;
- Përkushtimi i mekanizmave shtetëror duhet të fokusohet në eliminimin e dukurive të cilat e pengojnë integritimin e vendit në mënyrë që Kosova t'i hap rrugët e prosperimit sa më të shpejtë përkrah vendeve tjera të familjes evropiane;
- Mekanizmat europian në Kosovë, si Eulex dhe Zyra Ndërlidhëse e BE-së, duhet të forcojnë rolin e tyre përkrah insitucioneve tona në mënyrë që të kontribuojnë në avancimin e Kosovës më tutje në procesin eurointegruar;
- Lëvizja e lirë është një nga segmentet kryesore nga ku qytetarët dhe bizneset në përgjithësi mund të përfitojnë shumë dhe të marrin praktika të ndryshme, andaj BE-ja duhet të anagzohet që qytetareve të Kosovës t'i mundësohet lëvizja e lirë dhe mos të përcillet me kushtëzime të cilat nuk kanë pasur vendet e Ballkanit Perëndimor sepse në rajon Kosova është i vetmi vend i privuar nga kjo e drejtë;
- Biznesve kosovare duhet t'u mundësohen lehtësira të lëvizjes të mallrave duke hequr masat të cilat e pengojnë këtë qarkullim dhe t'u ofrohet ndihmë në përmbushjen e kriterëve të cilat janë kusht për integritim në tregun mbi 500 milion konsumatorëve, por njëheri duke i forcuar edhe nga pritshmeria dhe konkurrenca e fuqishme që mundët të vijë nga ana e BE-së.

LITERATURA

- Hajrullahu, V., & Curri, F., (2007) "Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore të Kosovës në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Europian", Prishtine, fq.3 <http://telegrafi.com/cka-eshte-msa-ja-dhe-cka-perfiton-kosova-nga-kjo/>
- Muharremi, R., (2008) KOSOVA DHE INTEGRIMI I SAJ NË BASHKIMIN EVROPIAN: Sfida e themelimit të shtetit funksional të bazuar në sundimin e ligjit, Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK), Prishtine fq.1
- Selimi, N., (2008) "Globalizimi ekonomik", Tetovë 2008, fq. 125.
- Smith, M., Keukeleire, S., Vanhoonacker, S., (2016) "The Diplomatic System of the European Union", New York fq.28.
- Staab, A., (2012) "The European Union Expland", London, fq. 9-11.
- Raporti i Ministrisë për Integritim Evropian dhe GIZ, "Task Forca për Integritim në Bashkimin Evropian", Prishtinë, Maj 2012, fq.11
- http://www.mei-ks.net/repository/docs/Terms_of_Reference_SQ.pdf
- Republika e Kosovës, Ministria e Integritimit Europian, Në dispozicion tek: <http://www.mei-ks.net/sq/strukturat-per-integrimbr-evropian>.
- [http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-\[shqip\].pdf](http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-[shqip].pdf),
- Republika e Kosovës-Presidenti, Këshilli Kombëtar për Integritim Europian, "STRATEGJIA KOMBËTARE INTEGRIMIN EVROPIAN KOSOVA 2020", fq.4-11, http://www.kryeministri.ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Integritimin_Evropian_Kosovo_2020_SHQ.PDF
- [http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-\[shqip\].pdf](http://www.fesprishtina.org/pdf/KOSOVO%20AND%20ITS%20INTEGRATION%20IN%20THE%20EU%20II-[shqip].pdf)
- Qendra Informativë dhe Kulturorë e BE-së, "MSA-ja për të gjithë: Çfarë duhet të dini për marrëveshjen për stabilizim dhe asociim ndërmjet BE-së dhe Kosovës?", Autor: Krenar Gashi, shih më shumë tek: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/161013_saa_sq_0.pdf.
- "Çka pas MSA-së mes BE-së dhe Kosovës", Në dispozicion tek: <http://koha.net/?id=31&o=647>.